



Ky projekt është  
financuar nga BE-ja



International  
Labour  
Organization

# Raporti mbi rishikimin e kolegëve të këshillave ekonomik dhe social të Ballkanit perëndimor

DIALOGU  
SOCIAL



# **Raporti mbi rishikimin e kolegëve të këshillave ekonomik dhe social të Ballkanit perëndimor**

(E drejta autorit) Copyright © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2017  
Botuar për herë të parë në 2017

Publikimet e Zyrës Ndërkombëtare të Punës gëzojnë të drejtën e autorit në bazë të Portokollit 2 të të drejtave Universale të autorit Konventa. Megjithatë, fragmente të shkurtra mund të shkëputen prej tyre dhe mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi. Për të drejtat e riprodhimit ose përkthimit, aplikimet duhet të bëhen te ILO. Publikimet (të Drejtat dhe Licencat), Zyra Ndërkombëtare e Punës, CH-1211 Gjenevë 22, Zvicër, ose me e-mail: [rights@ilo.org](mailto:rights@ilo.org). Zyra Ndërkombëtare e Punës mirëpret aplikime të tilla.

Bibliotekat, institucionet dhe përdorues të tjerë të regjistruar me një organizatë për të drejtat e riprodhimit mund të bëjnë kopje në përputhje me licencat e lëshuara për qëllime të tilla. Vizito faqen [www.ifro.org](http://www.ifro.org) për të gjetur organizatat që kanë të drejtat riprodhuese në vendin tuaj.

Botimi në Anglisht

ISBN: 978-92-2-131355-7 (web pdf)

Botimi në Shqip

ISBN: 978-92-2-830856-3 (web pdf)

Botimi në Maqedonisht

ISBN: 978-92-2-830867-9 (web pdf)

Botimi në Boshnjakisht

ISBN: 978-92-2-830868-6 (web pdf)

Botimi në Serbisht

ISBN: 978-92-2-830926-3 (web pdf)

Emërtimet e përdorura në botimet e ILO-s, të cilat janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, dhe prezantimi i materialit në të nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me statusin ligjor të secilit nga vendet, zonat ose territoret e autoriteteve të saj, në lidhje me kufizimin e kufinjve të saj.

Përgjegjësia për opinionet e shprehura në artikujt e shënuar, në studimet dhe në kontributet e tjera qëndron vetëm tek autorët e tyre, dhe publikimi nuk përbën një miratim nga Zyrat Ndërkombëtare e Punës në lidhje me opinionet e shprehura në to.

Referenca për emrat e firmave dhe produkteve dhe proceseve komerciale nuk nënkupon miratimin e tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, dhe çdo dështim për të përmendur një firmë, produkt apo proces të veçantë komercial nuk është një shenjë mosmiratimi.

Publikimet e ILO-s dhe produktet digjitale mund të merren përmes librave kryesore dhe platformave digjitale, ose të porositura direkt nga [ilo@turpin-distribution.com](mailto:ilo@turpin-distribution.com). Për më shumë informacion, vizitoni faqen tonë të internetit: [www.ilo.org/publns](http://www.ilo.org/publns) or contact [ilopubs@ilo.org](mailto:ilopubs@ilo.org).

# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtimeve</b>	<b>3</b>
<b>Përmbledhja ekzekutive</b>	<b>5</b>
<b>Mirënjohje</b>	<b>7</b>
<b>PJESA 1</b>	<b>8</b>
<b>Kapitulli 1</b>	
<b>Hyrje</b>	<b>9</b>
<b>Kapitulli 2</b>	
<b>Zbatimi i rishikimit të kolegëve</b>	<b>11</b>
2.1. Vetë-vlerësimi	11
2.2. Intervistat e rishikimit të kolegëve	12
2.3. Detyrat e realizuara nga ekipet e rishikimit të kolegëve	12
2.4. Plani i zbatimit i rishikimit të kolegëve	13
2.5. Zbatimi dhe rishikimi	13
<b>Kapitulli 3</b>	
<b>Gjetjet e përgjithshme</b>	<b>15</b>
3.1. Kuadri ekzistues ligjor dhe institucional për dialogun social trepalësh në nivel kombëtar	16
3.2. Strukturat e brendshme të disponueshme për mbështetjen teknike të proceseve të formulimit të rekomandimeve dhe opinioneve të KES (sekretariatët teknikë dhe komitetet e përhershme të specializuar)	17
3.3. Identifikimi i pengesave në proceset operative të KES	17
3.4. Anëtarët e KES dhe kontributet e tyre në debate	18
3.5. Ndikimi i rekomandimeve dhe opinioneve të KES	18
<b>Kapitulli 4</b>	
<b>Rekomandime të përgjithshme dhe veprime në lidhje me diskutime të mëtejshme dhe zbatime</b>	<b>19</b>
4.1. Mandati i KES	20
4.2. Sfondi konsultativ/Trajtimi i mangësive në implementim	20
4.3. Mbështetja ndaj KES- ekspertiza administrative, financiare, teknike dhe profesionale	21

## **Kapitulli 5**

### **Përmbledhjet e raporteve të shteteve:**

<b>Praktikat e mira specifike të vendeve, sfidat dhe rekomandimet</b>	<b>22</b>
5.1. Republika e Shqipërisë	22
5.2. Bosnja dhe Hercegovina	24
5.3. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	27
5.4. Mali i Zi	28
5.5. Republika e Serbisë	29
5.6. Kosova (në përputhje me kuptimin e Rezolutës Nr. 1244 të OKB)	31

## **PJESA 2**

### **Procedurat dhe rezultatet e Konferencës Nën-Rajonale të Nivelit të Lartë të PePÇS, 5–6 Korrik, 2017**

1. Hyrje	34
2. Përcaktimi i një agjende më të gjerë	34
3. Prezantimi i Raporteve të Shteteve	35
4. Përvojat krahasuese dhe frymëzuese të KES në vendet e përzgjedhura të BE-së (Poloni, Danimarkë dhe Portugali)	35
5. Mbyllja e hapësirave boshe : Sfidat dhe rrugët e mundshme për t'i kapërcyer ato	37
6. Sesioni i panelit: Vendi i KES në dialogun e ardhshëm social	39
7. Veprime dhe rekomandime të mëtejshme	40
7.1. Niveli nënrajonal	40
7.2. Të mësuarit e ndërsjellë	41

## **Aneksi**

### **Matrica përmbledhëse**

# Lista e Shkurtimeve

BeH	Bosnja dhe Hercegovina
PRE	Programi i Reformave Ekonomike
FeBeH	Federata e Bosnje dhe Hercegovinës
PePÇS	Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale
KES	Këshilli Ekonomik dhe Social
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
MMSR	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
KKP	Këshilli Kombëtar i Punës
TeR	Termet e Referencës





# Përmbledhja ekzekutive

Ky raport konsolidon gjetjet dhe rekomandimet e nxjerra nga Rishikimet e Kolegëve të Këshillave Ekonomik dhe Social (KES) të kryera në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë (Republika Srpska dhe Federata e BiH), Mal i Zi, Serbi, në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Kosovë (siç përcaktohet nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB). Gjithashtu bazohet në konkluzionet e Konferencës Nën-rajonale të nivelit të lartë, të mbajtur në Beograd me datën 5–6 Korrik 2017.

Ekipet trepalëshe të rishikimit të kolegëve, secili ekip i përbërë nga dy përfaqësues të KES, kanë shqyrtuar funksionimin e një pale të tretë me fokus në fushat e mëposhtme: roli dhe mandati i përcaktuar në legjislacionin kombëtar; disponueshmëria e burimeve teknike dhe financiare dhe mbështetja teknike e brendshme dhe e jashtme; përbërja, metodat e punës dhe proceset operative; ndikimi dhe shtrirja e rekomandimeve dhe opinionëve të KES.

Gjate dekadës së fundit, një infrastrukturë e gjërë për konsultime trepalëshe është vendosur në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky proces është mbështetur nga ratifikimi në tërësi i konventave kryesore të ILO-s, në veçanti Liria e Asocimit dhe Mbrojtja e të Drejtës për Organizimin e Konventës, 1948 (Nb.87), Marrëveshja Kolektive dhe e Drejta për Organizimin e Konventës 1949 (Nb. 98), dhe Konventa e Konsultimit Trepalësh, 1976 (Nb. 144). Institucionet e dialogut social janë rritur në shumicën e këtyre vendeve, shpesh me mbështetjen e ILO-s.

Aktualisht, arkitektura e marrëdhënieve industriale në të gjithë Ballkanin Perëndimor karakterizohet nga mbizotërimi i konsultimeve trepalëshe të institucionalizuara në nivelin e politikave, me një prani dhe efektivitet më të dobët të mekanizmave të negociatave kolektive.

Megjithë progresin e rëndësishëm të bërë në ndërtimin institucional, institucionet e dialogut social kanë ende dukshmëri të ulët në shoqëri dhe një ndikim të kufizuar në proceset e politikave kombëtare dhe hartimit të ligjeve. Përkushtimi i dobët i disa politikanëve të rëndësishëm në dialogun social trepalësh, mbështetja e kufizuar institucionale, dhe kapaciteti i pamjaftueshëm teknik të këtyre institucioneve për të dhënë këshilla të një cilësie të lartë në një gamë të gjerë të çështjeve komplekse ekonomike dhe sociale ndikojnë negativisht në impaktin dhe besueshmërinë e tyre në debatet kombëtare. Niveli i besimit mes aktorëve të dialogut social trepalësh është gjithashtu i ulët. Në disa raste, qeveria nuk e kupton fuqishëm rolin e saj si lehtësues, mbështetës dhe garantues i dialogut social të vërtetë dhe partnerët socialë dyshojnë në aftësinë e qeverisë për të kryer këtë rol. Partnerët socialë kanë mungesë të infrastrukturës organizative të nevojshme dhe të kapacitetit teknik për t'u angazhuar dhe për të ofruar kontributet e tyre të mundshme.

Në shumicën e vendeve në shqyrtim, mandati i KES është mjaft i gjerë për të përfshirë çështjet ekonomike dhe sociale. Kjo zakonisht përfshin reformat e punës dhe punësimit, masat fiskale dhe tatimore, kujdesin shëndetësor, arsimin dhe trajtimin, masat për zbutjen e pasojave të krizës ekonomike, konkurrencën dhe produktivitetin, ose privatizimin dhe reformat strukturore. Gjithsesi, dialogu social trepalësh shpesh perceptohet si përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë së Punës dhe jo si përgjegjësi e “të gjithë” qeverisë.

Ndërsa legjislacioni i shumicës së vendeve detyron qeverinë të kërkojë mendimin ose rekomandimin e KES për projektligjet dhe politikat që janë nën kompetencat e KES, ende nuk ekziston një praktikë e mirë-themeluar dhe e qëndrueshme e pajtueshmërisë me këtë rregull dhe një detyrim i tillë ligjri në përgjithësi është injoruar nga Ministrinë më të fuqishme (si ajo e Financave dhe Ekonomisë). Gjithashtu, në shumicën e rasteve nuk ka mekanizëm të institucionalizuar për monitorimin e veprimeve pasuese sipas rekomandimeve të KES.

Në shumicën e rasteve, vetëm afërsisht 50 përqind e të gjitha ligjeve të miratuara që janë nën fushëveprimin e kompetencave të KES janë diskutuar më parë nga KES kombëtar. Në shumicën e rasteve, anëtarët e parlamentit nuk janë në dijeni të opinionëve dhe rekomandimeve të KES, dhe as publiku i përgjithshëm.

Disa partnerë socialë mendojnë se nuk ka vullnet të mjaftueshëm politik nga ana e qeverisë në tërësi për të shfrytëzuar institucionet e disponueshme të dialogut social në potencialin e tyre të plotë dhe për të vënë dialogun e vërtetë politik në qendër të agjendës politike.

Si një konkluzion i përgjithshëm, të gjithë KES të rishikuar kanë kaluar nëpër një periudhë të vështirë duke reflektuar në çështjet ekonomike dhe sociale që rrjedhin nga kriza globale ekonomike dhe financiare, por ato kanë mbetur të paprekura në mënyrë efektive. Ky është një tregues i mirë i qëndrueshmërisë së tyre në kohë krize tregon mirë për të ardhmen e KES në nën-rajon.

Një numër rekomandimesh të përgjithshme dhe specifike të shteteve janë paraqitur me qëllim të adresimit të mangësive të indentifikuara dhe për të rritur rëndësinë e ndikimit të veprimeve të KES. Këto përfshijnë sigurimin e një fushëveprimi të gjerë të kompetencës ligjore të KES kombëtarë për të dhënë mendime dhe këshilla për agjendat e reformave ekonomike, sociale dhe të punës; duke përcaktuar detyrimin ligjor të Qeverisë si e "tërë" për të kërkuar dhe siguruar reagime në kohë për rekomandimet e KES, dhe një shpjegim për ndjekjen; pavarësisht nga kufizimet financiare, institucionet e dialogut social duhet të marrin konsideratë të veçantë dhe duhet të vihen në dispozicion burime adekuate për të funksionuar siç duhet; burime shtesë të ekspertizës profesionale dhe teknike duhen të eksplorojnë, veçanërisht nga institutet e sektorit privat, universitetet, institutet kërkimore dhe organizatat e shoqërisë civile; tema të reja për shqyrtimin e KES mund të lidhen me zhvillimin ekonomik, migracionin, sfidat që lidhen me format e reja të punësimit dhe të ardhmen e çështjeve të punës.

Në Konferencën Nën-rajonale të Nivelit të Lartë, çdo KES u ftua të përzgjidhte të paktën dy rekomandime për të vepruar në të ardhmen dhe për t'u angazhuar në zbatimin e mëtejshëm. Mes atyre të përzgjedhur, ka një angazhim për të arritur një marrëveshje trepalëshe mbi kriteret objektive dhe të lehta për tu kontrolluar të përfaqësimit; krijimin e një mekanizmi monitorues për ndjekjen e opinionëve të KES; miratimin e një ligji të ri mbi KES; fushata ndërgjegjësimit për rolin e KES me qeverinë dhe parlamentin; rritjen e bashkëpunimit me institutet kërkimore, akademikët dhe organizatat e shoqërisë civile.

# Mirënjohje

Ky raport është realizuar nga Kieran Mulvey, konsulent ndërkombëtar dhe Cristina Mihes, Specialiste e Lartë e Dialogut Social dhe Ligjit të Punës në ILO DWT/CO Budapest. Bazohet në raportet e hartuara nga ekipet e mëposhtme të rishikimit:

**Këshilli Kombëtar i Punës i Republikës së Shqipërisë (KKP):** Luljeta Krasta, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (anëtare e sekretariatit të KKP), Vjollca Cane, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (anëtare e sekretariatit të KKP), Arjola Alika, Sindikatat e Bashkuara të Pavarura të Shqipërisë, Kol Nikollaj, President i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (nënkryetar i KKP).

**Këshilli Ekonomik dhe Social i Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës (FeBeH KES)- Bosnja dhe Hercegovina:** Edhem Biber, President i KES të FBiH, Ernis Imamović, Ministria e Punës (në rolin e Sekretarit të KES të FBiH), Fikret Alić, Sindikatat e Bashkuara të Pavarura, Edin Ibrahimpašić, Shoqata e Punëdhënësve të FBiH.

**Këshilli Ekonomik dhe Social i Republikës Srpska (KES RS)- Bosnja dhe Hercegovina:** Mira Vasić, Asistente Ministri, Ministria e Punës, Ranka Mišić, Presidente e Sindikatave të Bashkuara të Pavarura të RS, Velka Odžaković, Sindikatat e RS, Momčilo Divčić, Shoqata e Punëdhënësve të RS, Milka Kantar, Shoqata e Punëdhënësve e RS, Bojan Smiljanić, Sekretar i KES RS.

**Këshilli Social i Malit të Zi (KS):** Vesna Simović Zvicer, Qeveria, Vukašin Zogović, Bashkimi i Sindikatave të Lira të Malit të Zi, Duško Zarubica, Sindikatat e Malit të Zi, Suzana Radulović, Shoqata e Punëdhënësve të Malit të Zi, Rumica Kostić, Bashkimi i Punëdhënësve të Malit të Zi, Nataša Vukašinović, Sekretare e KS.

**Këshilli Ekonomik dhe Social i Republikës së Serbisë (KES):** Zoran Lazić, Asistent i Ministrisë, Ministria e Punës, Duško Vuković, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Serbisë, Zoran Stojiljković, TU NEZAVISNOST, Svetlana Budimčević, Shoqata e Punëdhënësve të Serbisë, Dušan Petrović, Sekretar i KES.

**Këshilli Ekonomik dhe Social i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (KES):** Branko Lazarevski, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale, Betim Osmani, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale, Zivko Mitrevski, Federata e Sindikatave, Blagoja Ralpovski, Federata e Sindikatave, Belinda Nikolovska, Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë, Goran Neshevski, Sekretar i KES.


**Këshilli Ekonomik dhe Social i Kosovës** (*brenda kuptimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara*): Alban Bokshi, Ministria e Punës, Alush Sejdiu, Sindikata e Punëtorëve, Agim Shahini, Aleanca Kosovare e Biznesit, Parim Bajrami, Zyra Ekonomike e Kosovës.

Susanne Nielsen, CTA e projektit PEPÇS të ILO-s, me seli në Sarajevë, dha një kontribut të dobishëm dhe koordinoi aktivitetet mbështetëse të rishikimit të kolegëve, ndihmuar nga Melisa Osmić, Éva Mihlic, Koordinatorët Kombëtarë të ILO-s në vendet përkatëse (Zhuljeta Harasani - Shqipëri, Lejla Tanović – Bosnje dhe Hercegovinë, Emil Krstanovski – ish RJ e Maqedonisë, Jovan Protić - Serbi), Dorina Nika, asistente e projektit në Shqipëri, dhe Nina Krgović, menaxhere e projektit në Malin e Zi.

Athena Bochanis redaktoi versionin në Anglisht të raportit.

Raporti u rishikua dhe u miratua nga delegacionet trepalëshe të Këshillit Ekonomik dhe Social në fjalë gjatë Konferencës Nën-rajonale të Nivelit të Lartë të KES të mbajtur në Beograd në Korrik të 2017.

# PJESA 1



# 1. Hyrje

"Platforma për punësim dhe çështje sociale" (PEPÇS) është një projekt rajonal që Komisioni Evropian e financon me shumën e 3 milionë euro i cili zbatohet bashkërisht nga ONP dhe Këshilli rajonal për bashkëpunim në Republikën e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës (sipas kuptimit të Rezolutës Nr.1244 të UNSC). Zbatimi trevjeçar i projektit ka filluar në Prill të vitit 2016 dhe ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe kapacitetet institucionale të administratës dhe organizatat e punëdhënësve dhe punonjësve në mënyrë që të fuqizojë ato për të zhvilluar dhe në mënyrë efektive të zbatojnë reformat e tregut të punës dhe politikave sociale në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE. Ekipi i menaxhimit të projektit është i vendosur në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë. Mbështetja teknike për projektin është siguruar nga Ekipi i Punës së ILO-s/Zyra e selisë në Budapest (DWT/CO Budapest).

Ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor ndajnë karakteristika të ngjashme strukturore dhe cilësitë në drejtim të tregut të punës, duke përfshirë papunësinë e lartë dhe punëtorët joaktivë, financimin e politikës së dobët aktive të tregut të punës, të burimeve të kufizuara të shërbimeve publike të punësimit dhe të mospërputhjes në mes të kërkesës dhe ofertës së punës. Ndërsa krijimi i vendeve të punës mbetet një sfidë e rëndësishme për të gjitha këto ekonomi, bashkëpunimi rajonal është një element thelbësor i stabilizimit dhe lidhjeve ekonomike midis vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE. Në veçanti, në fushën e çështjeve të punësimit dhe atyre sociale, ekonomitë mund të shkëmbejnë përvoja, të mësojnë nga njëri-tjetri dhe kështu të zgjedhin praktikën e tyre të krijimit të politikave dhe zbatimin e tyre.

Një nga reformat, e cila është theksuar në agjendën e Evropës 2020 është forcimi i partnerëve socialë për t'u përfshirë në dialogun social përmes reformave ekonomike dhe sociale. Dialogu social Evropian është i njohur si një shtyllë e modelit social evropian. Dialogu social në mes të qeverive, punonjësve dhe punëdhënësve në të gjitha nivelet është vendimtar për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe punën e mirë të biznesit, si dhe për të krijuar një situatë ku të gjithë kanë mundësi të barabarta në aspektin e konkurrencës ndërkombëtare, kushte të mira pune dhe praktikave të mira të punësimit. Pjesëmarrja e organizatave të punëdhënësve dhe punëtorëve në proceset që çojnë në punësim dhe reformave sociale është thelbësore për suksesin dhe qëndrueshmërinë e tyre, siç është rëndësia që qeveritë i japin Këshillit Ekonomik dhe Social dhe rezultateve të tyre.

Pavarësisht nga progresi, dialogu social në Ballkanin Perëndimor mbetet i dobët dhe efektiviteti i dialogut social dhe marrëveshjes kolektive si mjete për qeverisjen e tregut të punës janë të sfiduara. Proceset e dialogut social janë të kufizuara nga diskutimet e polarizuara mbi tregun e punës dhe reformat e ligjit të punës, veçanërisht në periudhën e fundit sfiduese të recesionit.

Këshillat Ekonomik dhe Social (KES) janë themeluar si institucione kombëtare të dialogut social trepalësh me një rol konsultativ dhe këshillues mbi çështjet e punës, ato sociale dhe ekonomike të interesit të përgjithshëm kombëtar në proceset e krijimit të politikave.

Megjithëse shumica e këshillave socio-ekonomike kanë mekanizmat institucionale për drejtimin e mendimeve dhe rekomandimeve në drejtim të reformave sociale dhe ekonomike, duket se këto mekanizma nuk funksionojnë si duhet dhe se ndikimi i këshillave për krijimin e politikave është i kufizuar. Roli i pamjaftueshëm i dialogut social është shkaktuar kryesisht nga mungesa e mekanizmave efektivë për koordinim, nga kapaciteti i dobët teknik i këshillave dhe nganjëherë nga mungesa e vullnetit politik të pjesëmarrësve në dialogun social për të arritur një marrëveshje në bazë të kompromisit.

Projekti PEPÇS ka për qëllim përmirësimin e punës së këshillave socio-ekonomike dhe kapaciteteve institucionale dhe teknike të anëtarëve të saj në vendet e përfshira nga ky projekt, në mënyrë që ata të kontribuojnë në përmirësimin e dialogut social dhe zhvillimit institucional të institucioneve të tregut të punës, të gjitha me qëllim të krijimit të

mundësive për dialog efektiv social që do të çojnë përfundimisht në krijimin e vendeve të reja dhe më të mira të punës dhe në progresin ekonomik dhe social.

Seksioni 2 përshkruan rregullimet praktike për zbatimin e rishikimit të kolegëve, ndërsa seksioni 3 përshkruan gjetjet faktike në lidhje me mandatin, strukturën dhe funksionimin e shtatë Këshillave target ekonomik dhe social. Seksioni 4 analizon ndikimin e Këshillave dhe pasqyron rekomandimet për aktivitetet e ardhshme. Ky seksion reflekton një konsensus të gjerë rreth asaj se cilat veprime janë më të dëshirueshme për zbatim në të ardhmen. Këto përfshijnë (a) prani më të madhe ministrore dhe qeveritare dhe mbështetje për KES; (b) përmirësimin e burimeve teknike, njerëzore dhe financiare; (c) transparencë dhe diskutime më të mëdha në procesin e konsultimit dhe shpërndarjes së rezultateve; dhe (d) përmirësimi i komunikimit me parlamentin në lidhje me rolin, detyrat dhe rezultatet e KES.

Një analizë më specifike e gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve kombëtarë është dhënë në Seksionin 5, duke përfshirë një përmbledhje të rishikimit të kolegëve. Funksionimi i Këshillave ekonomik dhe social kombëtar ndryshon në aspektin e ndikimit, efektivitetit, mbështetjes nga pjesëmarrësit, njohjes së aktivitetit të KES dhe marrëdhënieve me qeveritë dhe parlamentët.

Çdo KES u ftua të zgjedhë të paktën dy rekomandime për veprime të ardhshme dhe për angazhim në të ardhmen, në Konferencën Nën-rajonale të Nivelit të Lartë në Korrik të vitit 2017 në Beograd. Procedura dhe rezultatet e Konferencës së Beogradit janë prezantuar në Pjesën 2 të Raportit. Gjetjet dhe rekomandimet e rishikimit të kolegëve, si dhe rekomandimet e përzgjedhura që do të zbatohen më tej nga KES përkatës janë përmbledhur në një Matricë që i bashkangjitet Raportit.

## 2. Zbatimi i rishikimit të kolegëve

Gjatë gjithë raportit, termi “KES” është përdorur për të gjitha shtetet për referencë më të lehtë.

Rishikimi i kolegëve në lidhje me funksionimin e KES në gjashtë vendet target u prezantua në seminarin nënrajonial të mbajtur në Becici, Mal i Zi, më 3-4 Tetor 2016, ku Këshillat Ekonomik dhe Social kombëtar u përfaqësuan nga delegacionet trepalëshe.

Me atë rast, ekipi i PePÇS prezantoi ushtrimin e rishikimit të kolegëve dhe Termat e Referencës të përgatitura nga ILO. Konsensusin e arritur në lidhje me mënyrën se si do të vepronin ekipet e rishikimit të kolegëve, lloji i angazhimit që kërkohet, formati i propozuar i pyetësorëve të intervistimit dhe angazhimit në “palë” të vizitave të rishikimit të kolegëve dhe u ra dakord mbi raportimet pasuese nga delegacionet pjesëmarrëse të KES.

Rishikimet e kolegëve në lidhje me strukturën, funksionimin dhe efektivitetin e KES kombëtarë janë zbatuar në gjashtë vendet target nga Nëntori i vitit 2016 deri në Mars të vitit 2017. Çdo këshill socio-ekonomik ka bërë vlerësimin e dy këshillave të tjerë dhe vetë ka kaluar një vlerësim nga dy këshilla përkatës. Duhet të theksohet se në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës janë bërë dy vlerësime të veçanta të Këshillit Ekonomik dhe Social të Republikës Srpska dhe Këshillit ekonomik dhe social të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, sipas kompetencave të entiteteve dhe strukturës kushtetuese dhe ligjore të shtetit.

Ekipet e rishikimit të kolegëve kishin si detyrë që të identifikonin shembujt e praktikave të mira dhe zgjidhjeve të reja dhe për të lehtësuar diskutimet në mes kolegëve për metodat më të mira për tejkalimin e sfidave të përbashkëta me të cilat përballen këshillat socio-ekonomik kombëtare me rastin e përpjekjes për të rritur ndikimin e tyre në debatin aktual në nivel kombëtar për reformat ekonomike dhe sociale strukturore.

Çdo këshill socio-ekonomik ka emëruar ekipin katër anëtarësh të përbërë nga një përfaqësues i qeverisë, një përfaqësues i punëtorëve, një përfaqësues i punëdhënësve dhe sekretari i këshillit. Këshillat kanë mundur të vendosin dhe të formojnë dy ekipe të ndryshme («ekipe që zëvendësohen»), secila prej të cilave do të bëjë një vlerësim për një këshill. Kështu, çdo këshill ka mundur të ndahet në dy ekipe që do të përfaqësohen nga persona të ndryshëm dhe/ose partnerë social. Për shembull:

- **Ekipi i parë për vlerësim:** Përfaqësuesi i qeverisë A, përfaqësuesi i punëdhënësve A, përfaqësuesi i punëtorëve A dhe sekretari i këshillit socio-ekonomik.
- **Ekipi i dytë për vlerësim:** Përfaqësuesi i qeverisë B, përfaqësuesi i punëdhënësve B, përfaqësuesi i punëtorëve B dhe sekretari i këshillit socio-ekonomik.

Delegacioni prej katër anëtarësh nga të dy vendet pjesëmarrëse kanë vlerësuar situatën dhe bënë rekomandimet, prej të cilave të paktën dy rekomandime pritet të implementohen deri në fund të periudhës së zbatimit të projektit. PEPÇS ka ofruar ndihmë në vlerësimin dhe hartimin e raportit përfundimtar, duke përfshirë edhe rekomandimet, për të siguruar cilësi të qëndrueshme të procesit dhe rezultateve të tij. Zyra e ILO-s në Budapest dhe Koordinatorët kombëtarë të ILO-s kanë ofruar këshilla teknike dhe logjistike dhe asistencë ekipeve të rishikimit të kolegëve përpara, përgjatë dhe pas vizitës. Vlerësimi konsistonte nga vetëvlerësimi (pjesa A) i këshillit që vizitohet dhe pyetësori (pjesa B) që do të përdoren për ekipet e vlerësimit, si mëposhtë:

## 2.1. Vetë-vlerësimi

Në mënyrë që të përgatiten për vlerësimin e këshillave socio-ekonomike, këshilli pritës realizoi një vetëvlerësim të legjislacionit ekzistues përkatës dhe rregulloreve, veçanërisht ndryshimet e fundit të Ligjit të Punës dhe ligjet e tjera kombëtare që kanë të bëjnë me dialogun social, rregulloret dhe marrëveshjet. Këtu përfshihet:

- Vlerësimi dhe efektet e kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues në funksionimin e vlerësimit të këshillit socio-ekonomik në aspektin e mandateve të tij, strukturës, përbërjes, mekanizmave e institucioneve të nënshtruara dhe përcaktuara; dhe
- Vlerësimi i mangësive ligjore dhe institucionale ekzistuese që pengojnë realizimin e një mënyrë efektive (prsh. duke prodhuar rezultatet e pritura), efikase (ekonomike) dhe dialogun social të koordinuar në nivel kombëtar.“

Vetëvlerësimi është dërguar te ekipet përkatëse të rishikimit të kolegëve 3 javë para vizitës dhe është diskutuar me ekipin gjatë vizitës.

## 2.2. Intervistat e rishikimit të kolegëve

Intervistat gjatë vlerësimit të gjendjes janë përqendruar në katër drejtimet e mëposhtme:

- I. Deri në çfarë mase kornizat ligjore dhe institucionale ekzistuese mbështesin dialogun efikas dhe efektiv trepalësh në nivel kombëtar.
- II. Procesi i formulimit të mendimeve/preferimeve-identifikimi i pengesave të mundshme në metodat aktuale të punës së këshillit socio-ekonomik dhe dhënia e rekomandimeve për përparimin e këtij procesi.
- III. Përbërja e këshillit socio-ekonomik dhe
- IV. Ndikimi i rekomandimeve dhe opinionëve të këshillit socio-ekonomik.

Gjatë këtyre vizitave, ekipet për vlerësimin e gjendjes kanë intervistuar edhe përdoruesit edhe anëtarët e këshillit socio-ekonomik në lidhje me aspektet e mësipërme.

## 2.3. Detyrat e realizuara nga ekipet e rishikimit të kolegëve

PËRSHKRIMI I DETYRËS	KOHA	REZULTATET DIREKTE
Rishikimi dhe grumbullimi i komenteve mbi draftin e Termave të Referencës të rishikimit të kolegëve (drafti është hartuar nga ONP), si pjesë e përgatitjeve për konferencën nënrajonale	Shtator 2016	Komente mbi draftin e Termave të Referencës të rishikimit të kolegëve.
Pjesëmarrja në konsultimet subrajonale. Qëllimi i takimit ishte vlefshmëria e termave të referencës për vlerësimin e situatës, si dhe për ekipet që të trajnoheshin mbi mënyrën e realizimit të rishikimit dhe përgatitjes së raportit të rekomandimeve. Përveç kësaj, një marrëveshje përfundimtare u arrit mbi çiftimin e ekipeve të KES për vizitën të pala e tretë, dhe u ra dakord mbi planin e udhëtimit në lidhje me vizitat.	Tetor 2016	Janë vërtetuar TeR të rishikimit të kolegëve. U ra dakord mbi planin e udhëtimit për ekipet



PËRSHKRIMI I DETYRËS	KOHA	REZULTATET DIREKTE
<p>Vlerësimi i situatës të këshillave socio-ekonomik kryhet në përputhje me detyrat e ratifikuara të projektit dhe vlerësimin e planeve të udhëtimit.</p> <p>Detyrat specifike përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prgatitja për misionin e vlerësimit, duke përfshirë zgjedhjen e ekipit për vlerësimin e gjendjes, koordinimin me ekipin e çiftuar, caktimin e takimeve me këshillat sociale dhe ekonomike të vendeve të tjera të cilat janë vlerësuar.</li> <li>• Vetëvlerësimi i legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse ekzistuese.</li> <li>• Pjesëmarrja në misionin e vlerësimit - në periudhë prej dy ditësh.</li> <li>• Draft raporti mbi vlerësimin e gjendjes së këshillit socio-ekonomik në një vend të caktuar në përputhje me formatin e raportimit, dhe me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë.</li> </ul>	Tetor 2016– Mars 2017	<p>Gjashtë raporte të vetëvlerësimit të legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse.</p> <p>Gjashtë raporte të rishikimit të kolegëve me rekomandime specifike për përmirësimin e funksionimit të këshillave kombëtar social dhe ekonomik në shtetet e përfshira në projekt.</p>

## 2.4. Plani i zbatimit i rishikimi të kolegëve

EKIPET PËR VLERËSIM	VIZITAT	KOHA
Kosova A, Shqipëria A	IRJ Maqedonisë	8–10 Nëntor 2016
Kosova B, IRJ Maqedonisë B	Republika e Shqipërisë	16–18 Janar 2017
Shqipëria B, IRJ Maqedonisë B	Kosova	7–9 Shkurt 2017
Serbia A, Mali i Zi A	Bosnja dhe Hercegovina	6–9 Dhjetor 2016
	Federata BdeH	7 Dhjetor 2016
	Republika Srpska	8–9 Dhjetor 2016
Mali i Zi B, Bosnja dhe Hercegovina B	Republika e Srbisë	24–26 Janar 2017
Serbia B, Bosnja dhe Hercegovina B	Mali i Zi	21–23 Shkurt 2017

Raportet për vlerësimin e situatës janë paraqitur në konferencën nënrajonale në korrik 2017 si pjesë e diskutimeve për veprimet e ardhshme për zbatimin e rekomandimeve të zgjedhura të këshillave socio-ekonomike. Përveç kësaj, përfaqësuesit e këshillave socio-ekonomike nga vendet anëtare të BE-së kanë marrë pjesë në takimin e përbashkët dhe kanë përmendur shembuj frymëzues të praktikës së mirë nga organizatat e tyre.

## 2.5. Zbatimi dhe rishikimi

Të gjitha ekipet për vlerësimin e gjendjes kanë bërë vizitat e tyre dhe kanë dorëzuar raportet gjatë periudhës nga shkurti deri në mars të 2017. Në bazë të intervistave me palët kyçe të kryera në vend, si dhe një rishikim me shkrim të dokumenteve dhe situatave përkatëse të paraqitur në vetëvlerësim të ofruara nga ana e vlerësuar e këshillit socio-ekonomik, nga secili grup i vlerësimit të gjendjes është kërkuar të paraqesë një raport mbi çështjet kyçe të mëposhtme:

- Mandati dhe roli i këshillit socio-ekonomik
- Sekretariati teknik i këshillit socio-ekonomik
- Anëtarët e këshillit socio-ekonomik
- Ndikimi i këshillit socio-ekonomik
- Rekomandimet për veprimet e ardhshme

Këto pesë komponentë kryesorë janë baza e përmbajtjes së raporteve të rishikimit të kolegëve. Ato kanë dhënë informata të paçmuara dhe njohuri mbi bazën ligjore/bazat rregulluese të raporteve të veçanta të këshillave socio-ekonomik, gjenezën historike të procesit modern të dialogut social, marrëveshjet që përcaktojnë proceset e tilla dhe punën në të gjitha diskutimet e tyre gjatë dekadës së kaluar.

Natyrisht, një theks më i madh u vu në çështjet që lidhen me praktikën e kohëve të fundit, rezultatet dhe sfidat që lidhen me krijimin e politikave.

Detajet dhe vëllimi i këtyre raporteve janë ndihmë e madhe në marrjen e një perspektive rajonale mbi çështjet e praktikave të zakonshme dhe të ndryshme të këshillave socio-ekonomike. Siç është shpesh rasti, kultura në një vendi, konteksti historik, social dhe ekonomik dhe praktika e marrëdhënieve insdustrial ndikon në mënyrën se si ata transmetojnë përvojën dhe praktikën e tyre në ligjet dhe rregulloret, dhe më pas në strukturat e tyre të qeveritare (si në nivelin institucional të këshillit socio-ekonomik, ashtu edhe në nivelin qeveritar ose parlamentar).

### 3. Gjetjet e përgjithshme

Vendet e Eupropës Qendrore dhe Lindore kanë një trashëgimi të përbashkët gati nga gjysmë shekulli të regjimeve socialiste. Si rrjedhojë, kjo ka çuar në krijimin e një lloj tipi paternalistë të dialogut social «që udhëheq qeveria», e cila ka ndikuar në mënyrën në të cilën partnerët socialë marrin pjesë në procesin e dialogut social trepalësh.

Jostabiliteti politik i nënrajonit, veçanërisht i shkaktuar nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, ka zgjatur me vite dhe ende nuk është tejkaluar plotësisht. Kjo ka penguar kalimin e lehtë nga ekonomia e mëparshme socialiste në një ekonomi të tregut dhe demokrate. Procesi i ngadalshëm i tranzicionit ka rezultuar në një rritje dramatike të papunësisë dhe uljen e fitimeve, si dhe përfitimet sociale, si dhe në përhapjen e varfërisë. Duke kufizuar të drejtat kolektive të punës që i ka përshpejtuar më tej efekti krizës globale ekonomike, fuqia dhe ndikimi i sindikatave është zvogluar, ndërsa zëri i NVM-ve që janë bërë shumë në përgjithësi nuk dëgjohet në dialogun trepalësh kombëtar. Një kontekst i tillë ka ngadalësuar në mënyrë të konsiderueshme zhvillimin e sistemit të qëndrueshëm të marrëdhënieve industriale në nënrajon.

Gjatë tranzicionit nga një ekonomi e centralizuar në një të tregut, të gjitha vendet e përfshira në projekt kanë krijuar institucione dhe mekanizma për dialog trepalësh social dhe marrëveshjeve kolektive. Parimet ligjore dhe institucionale për dialogun social janë të përfshira në ligjet kolektive të punës, pas rënies së regjimeve socialiste janë bërë pjesë të rëndësishme të sistemit të drejtësisë së punës. Aktualisht, marrëdhëniet industriale në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar nga dominimi i konsultimeve të institucionalizuara trepalëshe në nivelin e politikës shtetërore, në vend të marrëveshjeve kolektive. Gjatë dekadës së fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar infrastrukturën relativisht të gjera të konsultimeve tripalëshe. Ky proces është mbështetur me ratifikimin e gjerë të Konventave themelore të ONP, veçanërisht Konventën nr. 87 mbi lirinë e asociimit dhe mbrojtjen e të drejtës për organizim, Konventën nr. 98 në negociatat kolektive dhe të drejtën për tu organizuar dhe të Konventës nr. 144 për konsultimet trepalëshe. Në shumicën e këtyre vendeve, institucionet e dialogut social janë rritur, shpesh me mbështetjen e ONP.

Megjithatë, pavarësisht progresit të konsiderueshëm në ndërtimin e institucioneve të dialogut social, ato ende nuk luajnë rolin e tyre në mënyrë efektive. Kryesisht ato kanë dukshmëri të ulët në shoqëri dhe ndikim të vogël në politikën kombëtare dhe proceset e krijimit të ligjeve. Niveli i ulët i vullnetit politik për çështjen e dialogut social trepalësh, mbështetja e kufizuar institucionale dhe kapacitetet e pamjaftueshme teknike të këtyre institucioneve i pengon ato për të dhënë këshilla me cilësi të lartë në një fushë të gjerë çështjesh komplekse ekonomike dhe sociale negativisht ndikojnë në besueshmërinë e tyre në kontekstin e debateve kombëtare. Niveli i besimit ndërmjet pjesëmarrësve në dialogun social është ende i ulët. Në disa raste, qeveritë nuk e kuptonë plotësisht rolin e tyre si lehtësues, asistentë dhe garantues të dialogut social efektiv dhe të rëndësishëm dhe partnerët socialë kanë dyshime rreth aftësive të qeverisë për të luajtur këtë rol. Partnerët socialë kanë ende mangësi në lidhje me infrastrukturën organizative dhe kapacitetet teknike të nevojshme për angazhimin dhe dhëniën e kontributeve potenciale.

Që nga fillimi i krizës globale ekonomike dhe financiare që çoi në një rënie në punësim, efektiviteti i dialogut social dhe marrëveshjeve kolektive në procesin e pajtimit të pikëpamjeve rrënjësisht të ndryshme ndërmjet qeverive, organizatave të punëtorëve dhe punëdhënësve mbi çështjet kyçe në lidhje me reformimin e institucioneve të tregut të punës është vënë në pikëpyetje. Përfaqësuesit e punëdhënësve dhe qeverive shpesh insistojnë mbi masat për të rritur fleksibilitetin e tregut të punës si një përgjigje ndaj krizës ekonomike. Sindikatat kanë kundërshtuar fuqishëm masa të tilla, dhe theksojnë zbatimin e dobët të dispozitave të ligjit të punës, si dhe mungesën e politikave efektive për të krijuar vende pune të cilësisë. Në mënyrë të ngjashme, ka një dallim shumë radikal në mes të punëdhënësve dhe të punësuarve në vëllimin, përfshirjen dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve kolektive në të gjitha nivelet.

Partnerët trepalësh në vendet e përfshira në projekt shpesh janë bllokuar në procesin e dialogut social kombëtar, duke u detyruar që ti drejtohen ONP për këshilla teknike në lidhje me pikëpamjet e tyre të ndryshme dhe të kundërta.

ONP thekson a) nevojën për të respektuar dhe plotësisht të arrihen të drejtat e tyre themelore të punës në të gjitha situatat, sidomos në kohën e krizës ekonomike, b) nevojën për dialog efektiv social në mes të partnerëve të cilët njohin se pala tjetër është barabartë, legjitime, e pavarur dhe se ajo ka një besueshmëri; c) nevojën për të promovuar bisedimet kolektive si një mjet vetë-rregullues që plotëson ligjin që është në dispozicion për partnerët socialë dhe si një bazë e qëndrueshme për dialogun social trepalësh.

Për të përcaktuar korrelacionin ndërmjet kornizës së caktuar ligjore dhe institucionale dhe efektivitetin e këshillave socio-ekonomike, ne kemi nevojë për të vlerësuar nëse funksionet aktuale të sistemit institucional, funksionet dhe strukturat sigurojnë mbështetjen e dialogut social trepalësh për të prodhuar rezultate. KES duhet të jetë në gjendje të ndikojë në proceset legjislativë nëpërmjet dhënies së rekomandimeve të një cilësie të lartë mbi çështjet e interesit publik dhe kombëtar si dhe me ndihmën e monitorimit të zbatimit të tyre.

### 3.1 Kuadri ekzistues ligjor dhe institucional për dialogun social trepalësh në nivel kombëtar

Në shumicën e vendeve të përfshira në projekt, dialogu kombëtar trepalësh social është institucionalizuar nëpërmjet krijimit të këshillave socio-ekonomik trepalësh me kompetenca të përgjithshme mbi çështjet ekonomike dhe sociale me interes për shoqërinë e gjerë. Shumica e vendeve kanë nga një KES, por në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, ekzistojnë dy Këshilla Socio-ekonomik me përgjegjësi për dialogun social dhe marrëveshjet kolektive në nivel entiteti.

Baza ligjore për organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve është dhënë në Ligjin e Punës (Republika e Shqipërisë), me ligj të veçantë (Republik e Serbisë, Mali i Zi, BH-Republika Srpska) ose me bazë ligjore në Ligjin e Punës dhe marrëveshje trepalëshe ndërmjet qeverive dhe organizatave të punëtorëve dhe punëdhënësve që janë përfaqësues në nivel kombëtar (IRJM). Ligje të tilla ose marrëveshje për arritjen e misionit dhe mandatin e këshillave socio-ekonomike, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre kryesore, përcaktojnë përbërjen e tyre dhe mënyrën e përfaqësimit të palëve, përcaktojnë sistemin e votimit, detyrimin e parashikuar (IRJM, Serbia, BH-Republika Srpska) ose mundësinë e qeverisë dhe parlamentit për të kërkuar mendimin/rekomandimin e këshillit dhe të krijojnë një mekanizëm për të dërguar rekomandime/mendimet te institucionet relevante. Themelimi i organeve të përhershme të specializuara, dinamika e takimeve dhe burimet e metodat e financimit të gjitha aktiviteteve të këshillave socio-ekonomike.

Në shumicën e vendeve të përfshira nga ky vlerësim, mandati i këshillit kombëtar socio-ekonomik është mjaft i gjerë duke përfshirë fushën e gjerë të çështjeve ekonomike dhe sociale, dmth. të reformave të punës dhe punësimit, reformat fiskale dhe tatimore, arsimin dhe aftësitë, diskutimin mbi masat për të zbutur efektet e krizës ekonomike, konkurrencës dhe produktivitetit, privatizimi dhe reforma strukturore (Republika e Shqipërisë, Republika e Serbisë, BH-Republika Srpska). Kjo mundëson Këshillat përkatës të lidhen me reformat e përgjithshme të agjendës qeveritare ekonomike dhe sociale. Në disa raste, mandati i KES është kryesisht i lidhur me marrëdhëniet e punës, punësimin, pagat minimale, rritjen e pagave, zhvillimin e bisedimeve sociale, sigurimin shoqëror dhe pensionet (ish RJ e Maqedonisë).

Por, pavarësisht nga fakti se këshillat socio-ekonomike në përgjithësi kanë mandatin për të marrë me marrëveshje me një spektër të gjerë çështjesh ekonomike dhe sociale dhe për të diskutuar ato, shpesh dialogu trepalësh social është perceptuar si përgjegjësi e vetme e Ministrisë së Punës, dhe jo «e gjithë» qeverisë.

Legjislati në shumicën e vendeve përcakton një detyrim, për qeverinë që të kërkojë rekomandimet e këshillit socio-ekonomik. Megjithatë, ende nuk ka një praktikë standarde të respektimit të këtyre detyrimeve dhe shpesh këto detyrime injorohen nga ministritë relevante (psh. Ministria e Financave dhe ekonomisë).

## 3.2. Strukturat e brendshme të disponueshme për mbështetjen teknike të proceseve të formulimit të rekomandimeve dhe opinionëve të KES (sekretariatët teknik dhe komitetet e përhershme të specializuar)

Sekretariati i KES është pjesë e administratës që merret me çështjet e punës ose njësi administrative përgjegjëse në ministrinë e punës dhe çështjeve sociale (si në Republikën e Shqipërisë, IRJM), ose është më i pavarur dhe i lidhur direkt me këshillin socio-ekonomik (Republika e Serbisë, BH-Republika Srpska).

Në vendet e rishikuara, sekretari i këshillit socio-ekonomik është një ekspert teknik, një nëpunës shtetëror ose ish-punonjës i organizatave sindikale/punëdhënësve. Zakonisht ai/ajo propozohet nga Ministri i Punës (pas konsultimeve me partnerët socialë) ose vetë këshilli.

Buxheti i KES është zakonisht i siguruar nga buxheti i shtetit dhe menaxhohet brenda ndarjeve buxhetore të Ministrisë së Punës. Gjatë dekadës së fundit, buxhetet e këshillave socio-ekonomike janë reduktuar disi në përputhje me politikën e përgjithshme të reduktimit të shpenzimeve të shtetit. Megjithatë, në Republikën e Serbisë buxheti i këshillit për vitin 2017 është rritur. Për të ngritur nivelin e vetëdijes për rolin dhe punën e KES, të gjithë këshillët e rishikuar kanë theksuar sigurimin dhe mbrojtjen e burimeve adekuate financiare dhe teknike.

Derisa komitetet e përhershme të specializuara janë njohur si praktikë e mirë në të gjitha vendet e përfshira në projekt, duket se cilësia e punës së tyre mund të përmirësohet në mënyrë që të merret parasysh ekspertiza më e gjerë e shoqërisë civile (p.sh. grupet e ekspertëve, OJQ), të instituteve hulumtuese dhe akademike. Një numër zgjidhjesh të mundshme janë propozuar për të ndihmuar në arritjen e kësaj: krijimi i fondeve të hulumtimit përmes kontributeve të përbashkëta të përbërësve trepalësh (IRJM), ri-dizajnimi/plotësimi i buxhetit për projektet specifike (Republika e Serbisë), vendosja e bashkëpunimit pro bono me qarqet akademike, grupet e ekspertëve, OJQ-të dhe këshillat socio-ekonomike dhe të tjerë (Mali i Zi).

## 3.3. Identifikimi i pengesave në proceset operative të KES

Të gjitha vendet që kanë kaluar nëpërmjet vlerësimit të gjendjes, nuk kanë ende një praktikë ku qeveritë të kërkojnë opinionet ose rekomandimet e KES dhe të sigurojnë reagime në informacion të KES, madje edhe atje ku është detyrim ligjor i qeverisë për të bërë një gjë të tillë. Gjithashtu, nuk ka mekanizëm të institucionalizuar nëpërmjet të cilit qeveria/parlamenti të përcjellin aktivitetet që rrjedhin nga rekomandimet e këshillit socio-ekonomik. Në këtë kontekst, formulimi i mjeteve të monitorimit që do të jetë në dispozicion sekretariatit të këshillit është identifikuar si një shembull i praktikës së mirë (e zbatuar në IRJM) e cila mundëson arritjen e këtij qëllimi.

Arsyet e mundshme për mangësitë operative përfshijnë: (a) urgjencë të caktuar në krijimin e politikës/vendimit për shkak të procedurës ekzistuese të shkurtër për miratimin e ligjit/politikës, (b) prioritet i ulët i jepet dialogut social nga krijuesit e politikave dhe ministrinë, (c) afatet e shkurtëra që i jepen KES për të adoptuar rekomandimet (p.sh. 10 ditë në Republikën e Serbisë), (d) frekuenca e ulët dhe e parregullt e takimeve të KES (p.sh. në Republikën e Shqipërisë dhe IRJM), (e) proceset joefektive vendimmarrëse të shkaktuara nga sistemi joadekuat i votimit, debatet e polarizuara, ekspertiza e dobët teknike dhe hulumtimi joadekuat rreth çështjeve të ndërlikuara ekonomike dhe financiare (p.sh. përfaqësimi i madh i i tre palëve në Malin e Zi), (f) kërkesat procedurale për dorëzimin e rekomandimeve të këshillit socio-ekonomik janë shumë burokratike dhe zgjasin në kohë (p.sh. në Republikën e Serbisë mendimi për projektligjin së pari duhet të dërgohet ministrisë e cila ka propozuar draftin, dhe vetëm pas kalimit të 30 ditëve nëse nuk ka përgjigje, mund të dorëzohet direkt qeverisë), dhe (g) tendencat e caktuara të qeverive të anashkalojnë debatin me këshillin social dhe ekonomik dhe të miratonjë ligji me etiketimin « procedurë emergjente.»

### 3.4. Anëtarët e KES dhe kontributet e tyre në debate

Është vërejtur prezenca mjaft e dobët e ministrave në takimet e KES. Përjashtim bën Ministri i Punës i cili zakonisht kryeson këshillin social dhe ekonomik (përveç në rastin e Republikës së Serbisë dhe BH-Republika Srpska, ku ekziston sistemi i rotacionit). Praktika e zëvendësimit të shpeshtë të ministrave me zëvendësit e tyre ose me nënpunësit e rinj është vënë re.

Rregulli i konsensusit kryesisht zbatohet gjatë miratimit të rekomandimeve/mendimeve brenda KES. Megjithatë, ndonjëherë është e vështirë të arrihet konsensusi, veçanërisht në lidhje me reformat strukturore në kohën e krizës ekonomike, dhe ka raste kur konsensusi nuk mund të arrihet atëherë sugjerohet që rregulli i konsensusit të zëvendësohet me rregullin e shumicës. Gjithashtu, duke pasur parasyh rolin e përfaqësuesve të qeverisë në takimet e KES, që ka të bëjë kryesisht me shpjegimin dhe mbrojtjen e qëndrimit të qeverisë rreth një çështje ligjore ose politike dhe për të marrë reagime është vënë në pikëpyetje arsyetimi i votës qeveritare në miratimin e rekomandimeve.

Përgjithësisht, anëtarët e këshillit socio-ekonomik dhe komitetet e tyre të specializuara të përhershme marrin kompensim mujor për pjesëmarrjen e tyre në KES. Megjithatë, kjo praktikë ndryshon nga vendi në vend në rajon.

### 3.5. Ndikimi i rekomandimeve dhe opinioneve të KES

Është vërejtur se vetëm 50 për qind e numrit të përgjithshëm të projektligjeve të miratuara që janë nën fushëveprimin e kompetencave të KES janë diskutuar më parë nga KES kombëtar

Shumë shpesh parlamenti dhe deputetët nuk janë të vetëdijshëm për opinionet/rekomandimet e këshillit socio-ekonomik, dhe as opinioni i gjerë.

Disa partnerë socialë mendojnë se nuk ka vullnet politik të mjaftueshëm nga ana e qeverisë së e tërë për të përdorur institucionet e dialogut social të disponueshme në potencialin e tyre të plotë and për të vendosur dialogun politik të vërtetë si prioritet në agjendë.

Si një konkluzion i përgjithshëm, të gjithë KES kanë kaluar periudha të vështira, si pasojë e çështjeve ekonomike dhe sociale të krizës globale financiare dhe ekonomike, por kanë mbetur të paprekur. Ky është një tregues i mirë i qëndrueshmërisë së tyre në kohë krize dhe tregon mirë për të ardhmen e KES në nënrajon.

## 4. Rekomandime të përgjithshme dhe veprime në lidhje me diskutime të mëtejshme dhe zbatime

Prezantimet i'u dhanë mundësi pjesëmarrësve të kuptonin më mirë marrëdhëniet që ndikojnë në trendet cilësore dhe strukturat të cilat mundësojnë sukses në këshillat socialo-ekonomike dhe / ose situatën e kundërt, ku ka disa probleme që pengojnë zhvillimin dhe suksesin. Një analizë e tillë e çdo vendi ka mundësuar diskutim të fokusuar në atë që cilat pengesa për punën efektive të këshillit janë të dukshme dhe cilat duhet të trajtohen.

Këto njohuri ishin shumë të rëndësishme dhe një kontribut i madh për rekomandimet për secilin këshill socio-ekonomik që janë diskutuar në seancat e mëvonshme.

Përsëri, siç thuhet tashmë në raport, asnjë vend nuk ka dorëzuar raportin për këshillin e vet socio-ekonomik dhe delegacionet për vlerësimin ishin trepalëshe. Këto procese kanë dhënë një besueshmëri dhe vlefshmëri më të madhe të raporteve të ekipeve të vlerësimit.

Të dy seancat e dedikuara për këto raporte kanë mundësuar dhe lejuar pjesëmarrësit e konferencës dhe anëtarët e këshillit socialo-ekonomik për të:

- 1) Përmirësuar ndonjë aspekt të draft raportit që mund të ishte i pasaktë;
- 2) Të japin komentet e tyre mbi draft raportin dhe të diskutojnë rreth çështjeve që kanë nevojë për sqarim ose ndryshim; dhe
- 3) Informuar pjesëmarrësit për zhvillimet e fundit të situatës pas përfundimit të raporteve.

Seancat ofruan debate informative rreth çështjeve të ndryshme, duke përfshirë këtu dhe kapacitetet teknike të Sekretariateve, buxhetet, juridiksionin e këshillave socio-ekonomik, efektet e procesit të dialogut social, aspektet e krizës ekonomike dhe ndikimin e tyre në marrëdhëniet midis partnerëve trepalësh, mënyrën që qeveria përdor këshillat dhe nivelin e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, perceptimi i deputetëve dhe ministrave për punën e këshillit dhe roli i KES në formimin e politikave dhe legjisllacionit, si dhe zbatimin e rezultateve në kuadër të diskutimeve të KES.

### 4. Përvojat krahasuese dhe frymëzuese të KES në vendet e përzgjedhura të BE-së (Poloni, Danimarkë dhe Portugali)

**Këshilli Kombëtar për Dialog Social i Polonisë** u prezantua nga Znj Agata Oklinska (Zëvendës Drejtoreshë e Departamentit për Dialog Social/Dialog Partneritetesh, Ministria e Familjes, Punës dhe Politikës Sociale)

Funksionimi i SSD rregullohet nga dispozitat kushtetuese (nenet 12/20/59) në të cilët dialogu social është përshkruar si "një ligj themelor i vendit". Puna e tij është e bazuar në aktet kryesore ligjore të 1991 dhe 2015. Këshilli nuk zëvendëson qeverinë dhe parlamentin si organe kryesore vendimmarrëse, por është i përqendruar në arritjen e konsensusit në lidhje me objektivat kryesore të politikave ekonomike dhe sociale.

Që nga kriza ekonomike e vitit 2008, roli kryesor i Këshillit është reflektuar në zbutjen e efekteve të këqija të krizës mbi të punësuarit dhe punëdhënësit me ndihmën e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me makro-problemet në fushat kryesore të tilla si punësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e biznesit dhe formulimi i ligjeve të punës.

Për të arritur këtë, Presidenti i Republikës së Polonisë personalisht ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit nga viti 2013 deri në vitin 2016. Ligji për dialogun social i vitit 2015 ka forcuar rolin e Këshillit në kontekstin e procesit legjislativ dhe ka lehtësuar dialogun social dypalësh dhe trepalësh. Gjatë kësaj periudhe, mbi 800 mendime u formuluar, disa nga ato kanë të bëjnë me projektligjet e paraqitura nga ministrinë e ndryshme. Këshilli ka qasje në Gjykatën e Lartë në kuadrin e kërkesave për sqarime që mund të dalin nga nevoja për sqaruar ligje të ndryshme.

Në këshill ka përfaqësues të spektrove të shoqatave të ndryshme të punëdhënësve dhe sindikatave dhe disa ministra të rëndësishëm nga organet kryesore të qeverisë. Kryetari i Këshillit ndërrohet me rotacion nga përfaqësuesit e përbërësve.

Arritje të mëdha për Këshillin në vitin 2017 kanë qënë, marrëveshja mbi Ligjin e Punës dhe Ligjin e Prokurimit Publik. Në Qershor të vitit 2017 Presidenti mori pjesë në një seancë plenare të Këshillit. Një aspekt tjetër i funksionimit efektiv të këshillit janë Ekipet Sektoriale Trepalëshe që merren me çështje të rëndësishme të politikës ekonomike dhe sociale dhe me zgjidhjet e mundshme për problemet që mund të ndodhin. Momentalisht po zhvillohen diskutime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për këshillin e dialogun social të vitit 2015.

**Këshilli Kombëtar i Punësimit të Danimarkës** u prezantua nga Z. Joergen Bang – Petersen, Këshilltar i Lartë për Konfederatën e Punëdhënësve Danezë.

Z. Bang-Petersen ka përshkruar shkurtimisht sistemin Danez të punësimit dhe “fleks-sigurimin” si dhe sistemin kombëtar/rajonal lokal të organizimit të aktiviteteve në tregun e punës. Këshilli Kombëtar për Punësim vepron nën kujdesin e Ministrisë së Punësimit dhe është organ që këshillon Ministrin mbi të gjitha aspektet e politikës së punësimit për tetë tregjet rajonale të punës dhe 98 bashkitë e Danimarkës.

Këshilli përbëhet nga një kryesues dhe 24 përfaqësues të partnerëve socialë, bashkive dhe Këshillit të Organizatave Daneze për Personat me Aftësi të Kufizuara. Këshilli është përgjegjës për të gjitha nismat e mëdha që kanë të bëjnë me tregun e punës, trajnimin, qëllimet vjetore në fushat e punësimit dhe skemave pilot-për integrimin dhe qasjet në fuqinë punëtore.

Negociatat trepalëshe janë kryer gjatë disa viteve dhe kanë rezultuar në disa marrëveshje që lidhen me tregun e punës dhe planifikimin e fuqisë punëtore, si marrëveshjen mbi reformat e pensioneve të vitit 1987 dhe dy marrëveshje të vitin 2016 që kanë të bëjnë me zhvillimin e trajnimit dhe integrimin në vendin e punës.

Si përfundim, Z. Bang-Petersen i'u referua disa aspekteve kryesore për të arritur rezultate të suksesshme si; të gjitha interesat duhet të përfaqësohen, numri i pjesëmarrësve duhet të jetë i kufizuar; roli dhe përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit duhet të jetë e qartë dhe e bazuar në ligj, sekretariati duhet të jetë profesional me qasje në bazat dhe hulumtim dhe palët duhet të jenë të prirura të arrijnë konsensusin në koordinimin e aktiviteteve të tyre brenda Këshillit.

**Këshilli Ekonomik dhe Social i Portugalisë** u prezantua nga Zonja Caterina Braga, Eksperte e Lartë e ONP të Portugalisë. (Ish-Sekretare e Përgjithshme e KES të Portugalisë).

KES i Portugalisë është themeluar sipas ligjit të miratuar në vitin 1991 dhe mandati i tij kryesor është që të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve socialë në vendimmarrje në politikat sociale dhe ekonomike. Ai ka një rol konsultativ dhe jep mendime për agjendën ekonomike dhe sociale, për institucionet evropiane dhe fondet evropiane, por gjithashtu luan një rol të rëndësishëm dhe kyç në çështjet që lidhen me dialogun social dhe marrëdhëniet industriale.

Puna e këshillit zhvillohet nga Bordi i Drejtorëve, Këshilli Koordinues dhe katër komitete të përhershme. Komiteti më i rëndësishëm është Komiteti i Shoqërimit Social, i cili përbëhet nga gjashtë përfaqësues të qeverisë, katër përfaqësues të sindikatave dhe katër përfaqësues të punëdhënësve.



Vetë këshilli ka 66 anëtarë, duke përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile dhe ka katër nënkryetarë dhe organizon gjashtë seanca plenare në vit. Vlen të përmendet se kryetari i këshillit zgjidhet nga parlamenti (me dy të tretat e votave) dhe se mandati i tij zgjat aq sa zgjat dhe afati i parlamentit.

Këshilli ka arritur rezultate të rëndësishme dhe mbresëlënëse gjatë recesionit dhe rrethanave të vështira që përfshijnë “troikën” ndërkombëtar. Këshilli formuloi rekomandime në lidhje me Planin Kombëtar për Reformat në vitin 2016 dhe përsëri në vitin 2017, në lidhje me Buxhetin Kombëtar dhe riorganizimin lokal të qeverisë ku përfshihen rishpërndarja e fuqive brenda bashkive. Rezultatet e tjera kanë lidhje me marrëveshjen për pagën minimale, promovimin e dialogut social dhe të konkurrencës së biznesit, kohezionit social dhe reduktimin e kostove të sigurimeve shoqërore të paguara nga punëdhënësi për të garantuar punësimet dhe modernizimin e tregut të punës, por gjithashtu ka miratuar disa opinione të përbashkëta për çështje të ndjeshme.

Gjithashtu, Këshilli ka autoritet për të kryer arbitrazh në rast të mosmarrëveshjeve dhe e ka ushtruar këtë autoritet në disa raste që nga viti 2009.

Zonja Braga në fund të fjalës së saj ka paraqitur një mesazh kyç, shumë të rëndësishëm, i cili është se gjatë periudhës që mbulon programi i rregullimit, dialogu social nuk është ndërprerë asnjëherë.

## 5. Mbyllja e hapësirave boshe: Sfidat dhe rrugët e mundshme për ti kapërcyer ato

Udhëheqësit e këtij sesioni ishin Cristina Mihes, ONP dhe Kieran Mulvey, Ekspert Ndërkombëtar dhe ish Drejtori i Përgjithshëm i Komisionit për marrëdhëniet e punës së Irlandës), Fokusi ishte në gjetjet e përgjithshme dhe specifike nga raportet e ekipeve për vlerësimin e gjendjes dhe në “Matricën Përmbledhëse”, të cilat janë bashkangjitur dokumenteve të përgatitura për konferencë.

Znj Mihes i'u referua komenteve të Seksionit 3 të draft raportit (Gjetjet e përgjithshme) dhe sfidave dhe praktikave të mira të identifikuara në këtë raport, bazuar në vëzhgimet e përgjithshme të ekipit të rishikimit të kolegëve.

Trashëgimia e përbashkët përse i përket sistemit të punës dhe marrëdhënieve industriale, kultura dhe praktika e dialogut social dhe agjenda të ngjashme politike që kanë si qëllim anëtarësimin në BE shpjegon zgjidhjet ligjore dhe institucionale të zgjedhura nga vendet për të lehtësuar dialogun social trepalësh. Vendet e përfshira në projekt përballen me sfida të ngjashme në drejtim të aftësimin të institucioneve të dialogut social për funksionimin efektiv dhe efikas. Përgjithësisht, qeveritë nuk po shfrytëzojnë praktikën e marrjes së opinioneve nga KES dhe ndjekjen e tyre pas bërjes së rekomandimeve. Sekretariatët nuk kanë kapacitet teknik të mjaftueshëm për të mbështetur KES të tyre dhe nuk ka ekspertizë të mjaftueshme dhe mjete analitike.

Natyrisht, ka shumë sfida të rëndësishme në aspektin e ndërveprimit, funksionimit dhe pjesëmarrjes aktive të përfaqësuesve të qeverisë në punën e këshillit socialo-ekonomik. Ndërsa në shumicën e rasteve baza ligjore për punën e këshillit është solide dhe i nënshtrohet rishikimit periodik, ka raste të vendeve të veçanta, ku mandati i këshillit duhet të jetë më i gjërë sesa thjesht çështjet që kanë të bëjnë me temat e punës.

Nuk ka dyshim se burimet teknike në dispozicion të këshillave socio-ekonomike janë mjaft të kufizuara dhe se në disa raste janë reduktuar edhe më tej gjatë krizës financiare. Kjo sfida duhet të adresohet në mënyrë që këshillat të ruajnë kredibilitetin e tyre në nivel kombëtar, për të rritur kapacitetin e tyre operativ dhe në mënyrë që të trajtojnë çështje gjithnjë e më komplekse të dialogut social dhe efektet e tyre aktuale në shoqëri, në vendet e punës dhe qasjet e punësimit si pasojë e recesionit global.

Përshtatja me këto rezulate kërkon vullnet politik dhe përfshirje të vërtetë të të gjitha palëve në procesin e dialogut social. Kjo do të lejojë shoqëritë që të shmangin qasjet konfrontuese dhe të njëanshme dhe “procedurat emergjente” në lidhje me politikën, hartimin e ligjeve dhe planifikimin e buxhetit.

Të gjithë partnerët trepalësh duhet të rrisin kapacitetet e tyre për t'u angazhuar në prioritetet kyçe për një progres të qëndrueshëm dhe të punojnë për të arritur qëllimet e përbashkëta në mënyrë që të bien dakord për zgjidhjet dhe pastaj t'ju përmbahen këtyre angazhimeve. Për më tepër, KES kanë rol thelbësor ligjor dhe institucional në arritjen e objektivave për anëtarësim në BE dhe të konventave kryesore, veçanërisht Konventat nr. 87, 98 dhe 144.

Z. Mulvey prezantoi një përmbledhje të pengesave kryesore në rrugën e arritjes së suksesshme të rezultateve të KES:

- konsultime të pamjaftueshme ose mungesë përfshirjeje të partnerëve socialë në fazat e hershme dhe angazhim i vogël i zyrtarëve të lartë të qeverisë;
- "monitorim" i pamjaftueshëm i rezultateve në fazën përfundimtare;
- anashkalimi i procesit të dialogut social nga qeveria nëpërmjet "procedurave urgjente";
- afatet kohor të shkurtër për formulimin e rekomandimeve dhe analizave dhe debateve për të çuar në konsensus dhe përmirësim të cilësisë së rekomandimeve;
- procedura të gjata për kanalizimin e rekomandimeve te ministrinë dhe pastaj te qeveria;
- bllokim të diskutimeveku nuk ka konsensus; dhe
- mungesë e burimeve dhe ekspertizave teknike të sekretariatit.

Z. Mulvey ka përmendur rekomandimet specifike të bëra në raportet e ekipeve për vlerësimin e gjendjes dhe të cilat janë përmbledhur në draft raportin dhe në «Matricën Përmbledhëse». Ai falënderoi ekipet për vlerësimin e gjendjes dhe këshillat socialo/ekonomike kombëtare në kontributet e tyre profesionale dhe të detajuara dhe punën që kanë bërë në shkrimin e raporteve të tyre.

Rekomandimet janë dhënë në dy kolona. Njëra kolonë përmban shumicën e rekomandimeve të bëra në raportet e ekipeve të vlerësimin të situatës, dhe kolona e dytë përmban ato rekomandime të cilat vetë këshillat kanë zgjedhur si prioritetet për veprim dhe zbatim gjatë 12 muajve të ardhshëm.

Republika e Shqipërisë ka zgjedhur tre rekomandime specifike: konsultime në fazat e hershme me KES, monitorimin e progresit në zbatimin e rekomandimeve dhe fuqizimin e Sekretariatit duke përfshirë edhe rishikimin e kriterëve të përfaqësimit dhe rregulloreve në lidhje me këto kriterë. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës selektoi rekomandimin në lidhje me hartimin e një ligji të ri që do të rregullojë punën e këshillit socialo-ekonomik. Raporti i ekipit të rishikimit të Republikës Srpska të BeH përfshiu disa rekomandime specifike, si nevojën për të rritur mbështetjen teknike, forcimin e marrëveshjeve kolektive, revitalizimin e procesit të dialogu social, sigurimin e pjesëmarrjes më të madhe të qeverisë në nivel ministror dhe sigurimin e një qartësie më të madhe në lidhje me rregullat dhe rregulloret e veprimit të KES. KES i Republikës Srpska të BeH u angazhua për të punuar në cilësinë e procesit të dialogut social dhe për të rritur numrin e komiteteve të përhershme të KES.

Raporti i KES të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ka theksuar tre rekomandime: rritjen e nivelit të ekspertizës teknike të disponueshme për KES (si organet kërkuese, akademike dhe organizatat civile); vendosjen e procedurave për të siguruar që projektligjet dhe dokumentet/ politikat e rëndësishme strategjike nuk mund të futen në procedurë parlamentare pa u shoqëruar me mendimin/rekomandimin e këshillit socialo-ekonomik; dhe është e nevojshme për të filluar një fushatë për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të deputetëve / ministrave për çështjen e përfshirjes së tyre në procesin e dialogut social dhe rezultateve të tij. Rekomandimet e ekipit të rishikimit të Malit të Zi u fokusuan në ndikimin e ministrave, madhësia e KES dhe mosefikasiteti që rrjedh nga një gjë e tillë, thjeshtëzimi i sistemit të votimit dhe kapaciteti teknik. KES selektoi për ndjekje dy rekomandimet e para.

Raporti i Republikës së Serbisë paraqiti një sërë rekomandimesh. Raporti gjithashtu shoqëroi çdo rekomandim me shpjegime ku përfshihen dhe vëzhgimet specifike, autoritetet që kanë përgjegjësi për zbatimin e rekomandimeve. Rekomandimet kishin të bënin me përfshirjen e të gjitha palëve në fazat e hershme të procesit të konsultimit, raportimin e opinionëve dhe diskutimet e KES me Qeverinë dhe Parlamentin, rritjen e kapacitetit dhe statusit të Sekretariatit, konsiderimin e zëvendësimit të rregullit të konsensusit me një sistem cilësor të shumicës, sigurimin e pranisë konstante të qeverisë për ti dhënë KES autoritet dhe fuqizimin e procesit të marrëveshjeve kolektive, veçanërisht në sektorin privat. KES zgjodhi tre rekomandime për zbatim të mëtejshëm ku përfshihen komunikimi i opinionëve dhe diskutimeve të tij Parlamentit, prezantimin e reagimeve më të shkurtra të kërkesave dhe puna për njohjen më të mirë të rolit të tij të Qeveria.

Ekipi për vlerësimin e gjendjes që vizitoi Kosovën (në kuptimin e Rezolutës 1244 të KS të OKB) ka theksuar katër fusha ku veprimi është i nevojshëm në mënyrë që të maksimizohet efektiviteti i këshillit socialo-ekonomik. Ata theksuan nevojën për dukshmëri më të madhe të rolit dhe sukseseve të KES, miratimin e strategjisë së komunikimit për KES, nevojën për mbështetje më të madhe teknike dhe financiare dhe pjesëmarrje konsistente të qeverisë në një nivel më të lartë. KES u angazhua që të hartojë dhe të miratojë një strategji komunikimi për periudhën 2018-20 dhe sigurimin e zyrave të përhershme dhe buxhetit për veprimin e tij.

Për të përmbledhur, Z. Mulvey i'u referua shkallës së konsiderueshme të unanimitetit midis KES lidhur me sfidat kryesore që hasin ato, pavarësisht nga rrethanat e veçanta lokale dhe mjediset e ndryshme ekonomike. Ai përmendi rekomandimet specifike të bëra për secilin KES dhe dha disa sponde për secilën nga rekomandimet specifike.

## 6. Sesioni i panelit: Vendi i KES në dialogun e ardhshëm social

Në sesion specifik drejtuar nga Youcef Ghellab, Kryetar i Njësisë për Dialog Social, ILO-Gjeneva, ku përfshiheshin Z. Vukasin Zogovic, (Zëvendës GS, Unioni i Sindikatave të lira të Malit të Zi), Znj. Belinda Nikolovska (Drejtoreshë Ekzekutive, Organizata e Punëdhënësve e ish RJM), dhe Z. Goran Neshevski, (Sekretar, KES, ish RJM) u diskutua mbi kontributet e rëndësishme që KES sjellin në arkitekturën institucionale të procesit të dialogut social kombëtar.

Z. Ghellab deklaroi që në shumicën e vendeve, institucionet kombëtare përgjegjëse për dialogun social trepalësh janë krijuar gjatë periudhës prej 15-20 vjet më parë në një mjedis social dhe ekonomik që ishte shumë ndryshme nga i tanishmi. Ekonomia e re globale është e karakterizuar nga ndryshimet masive dhe të shpejta teknologjike dhe të drejtuara nga katër nxitësit kryesore të këtyre ndryshimeve:

- ndryshimet teknologjike që përfshijnë internetin dhe teknologjitë përkatëse;
- popullsi më e vjetër;
- ndryshimet klimatike dhe pasojat e saj për mjedisin jetësor, burimet natyrore dhe prodhimin e ushqimit; dhe
- globalizimi më intensiv dhe ndikimi i tij mbi migracionin, rritjen e pabarazisë dhe rritjen e grupeve vulnerabël (të ndjeshme) në shoqëritë tona.

Paneli trepalësh ka dhënë mundësinë për prezantimin e pikëpamjeve të ndryshme të përbërësve për rolin që institucionet kombëtare për dialogun social mund të luajnë në të ardhmen, duke pasur parasysh proceset masive dhe transformimet e thella që po ndodhin në botën e punës dhe në mjediset e punës. Pyetjet kryesore të panelistëve u fokusuan në sfidat dhe mundësitë e institucioneve për dialog social, të tilla si KES dhe mbi mënyrën se si ato mund të mbeten relevante dhe proaktive, duke ndhmuar qeveritë, sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve në arritjen dhe

mbajtjen e konsensusit në këto rrethana socio-ekonomike që ndryshojnë aq shpejt.

Panelistët në përgjithësi ranë dakord se ka shumë sfida për shoqërinë, dhe nganjëherë pikëpamjet e ndryshme janë konfrontuar nga partnerët trepalësh. Përsa i përket reagimit ndaj deklaratave të bëra nga z. Ghellab, pjesëmarrësit theksuan se aktualisht ka vështirësi të mëdha në arritjen e një konsensusi për çështje të tilla si e drejta e punës, përcaktimin e pagave në sektorin privat dhe publik dhe shpenzimet publike në lidhje me privatizimin, shëndetësinë, arsimin dhe sigurinë sociale, si dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Punëdhënësit ndjehen se janë nën presion për shkak të numrit të madh të rregulloreve, mungesa e stimulimit për punësim dhe tatimet mbi kompanitë. Ndërsa sindikatat besojnë se ligjet e punës nuk i mbrojnë mjaftueshëm të drejtat e punëtorëve / sindikatave dhe strukturave për marrëveshje kolektive dhe se në disa raste konventat e ONP janë injoruar.

Pjesëmarrësit thanë se prezantimet e mëparshme, që kishin të bënin me Poloninë, Danimarkën dhe Portugalinë dhe që përfshinin sfida të ngjashme që KES po kalon apo strukturat e tjera relevante trepalëshe, ishin shumë informuese dhe kanë dhënë një mesazh pozitiv për të ardhmen. Të gjithë pjesëmarrësit në konferencë u pajtuan se është e nevojshme të ritheksojnë Konventat kryesore të ONP në lidhje me konsultimet trepalëshe, marrëveshjet kolektive, dhe se është e nevojshme njohja më e madhe dhe promovimi i këtyre konventave esenciale dhe të rëndësishme.

## 7. Veprime dhe rekomandime të mëtejshme

Pesë tituj tematik janë identifikuar për diskutime në grupe, të cilët janë hartuar për të siguruar udhëzime dhe të ndihmojë në formulimin e veprimeve kryesore dhe objektivave për secilin KES.

- Ndryshimet ligjore të nevojshme për të rritur efektivitetin e KES
- Krijimi i një sistemi për të monitoruar mendimet dhe rekomandimet e këshillave social dhe ekonomik dhe metodat më efektive për bashkëpunimin me ministrat dhe parlamentet.
- Ngritja e kapaciteteve të sekretariatit të këshillave socialo-ekonomike
- Programet për ngritjen e vetëdijes ndaj vendimmarrësve dhe publikut të gjerë mbi rolin e KES
- Zbatimi i Konventës Konsultuese Trepalëshë së ONP, 1976 (Nr.144) (Standardet Ndërkombëtare të Punës).

Dy sesione u organizuan nga fundi i konferencës në mënyrë që pjesëmarrësit të arrinin në një marrëveshje për veprimet kryesore që do të ndihmonin në përmirësimin e efektivitetit të KES dhe që do të çonin në rezultate të qëndrueshme, dhe ndërmjet KES dhe brenda çdo KES. Grupet e punës identifikuan aktivitetet e mëposhtme për t'u ndërmarrë në të ardhmen e shpejtë në kuadër të projektit PEPÇS.

### 7.1. Niveli nën-rajon

#### 1) Organizimin e një seminari nënrajon mbi kuadrin e rregulloreve që ndihmojnë efektivitetin e KES

Shumë epike të rishikimit të kolegëve raportuan se një shkallë më e lartë e qartësisë ligjore ishte e nevojshme për qëllimin dhe funksionin e KES. Për këtë shkak, shumë qeveri dhe ministri dështojnë të konsultohen në mënyrë adekuate me KES dhe me partnerët socialë rreth hartimit të ligjeve dhe politikave. Një kërkesë specifike për asistencë teknike rreth hartimit të një ligji të ri të KES u paraqit nga KES i Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës.

Qëllimi i këtij seminari do të ishte identifikimi i pengesave ligjore që aktualisht pengojnë funksionimin e duhur dhe efektiv të KES dhe diskutimin e zgjidhjeve të zbatueshme për t'i adresuar.

Afati: fundi i vitit 2017.

## 2) Zhvillimi i trajnimit nënrajonal dhe krijimit të kapaciteteve për sekretariatet e këshillave social dhe ekonomik

Çdo vend ka raportuar për sfidat specifike më të cilat këshillat e tyre socialo-ekonomike përballen. Janë përmendur arsye të ndryshme për këtë situatë, por një gjë është kristalizuar gjatë seancës në të cilën përfaqësuesit e sekretariatit kanë marrë pjesë – KES janë të mbingarkuar me shumë pak mbështetje dhe asistencë.

Një faqe rajonale interneti e hartuar në mënyrë specifike mund të ndihmojë KES në masë të madhe në lidhje me shpërndarjen e informacionit, përditësimin në lidhje me zhvillimet ligjore dhe ndjekjen e punës së KES të tjerë. Ata deklaruan se do të duhet një program i veçantë trajnimi për të mësuar aftësi të reja, sidomos duke pasur parasysh se në kuadër të këshillit duhet të performojnë funksione të ndryshme. Shumë i rëndësishëm për ata ishte krijimi i një “bashkësie ekspertësh” që do të mbështesnin njëri-tjetrin dhe të shkëmbejnë informata dhe përvoja.

Afati: fundi i vitit 2017.

## 3) Mbajtja e një konference nënrajonale mbi zbatimin e rekomandimeve të përzgjedhura

Pjesëmarrësit ishin të mendimit që do të ishte e rëndësishme për ruajtjen e kohezionit të projektit organizimi i një seminari ndjekës për të lejuar KES individual të ndajnë eksperiencat e tyre në zbatimin e rekomandimeve që kanë marrë përsipër në këtë konferencë.

Kjo gjithashtu do të ishte një mundësi për KES të identifikojnë fusha të tjera problematike që mund të kenë nevojë për vëmendje në të ardhmen.

Afati: fundi i 2018

## 7.2. Të mësuarit e ndërsjelltë

### 1) Organizimi i “Ditës së informimit të KES” për anëtarët e parlamentit.

Kjo ditë do të ishte për të informuar shkurtimisht anëtarët e parlamentit rreth programit të punës së KES dhe do të rriste ndërgjegjësimin mbi punën e KES. Pjesëmarrja e anëtarëve Europian të parlamentit do të kërkohet nga projekti.

Afati: fundi i 2018

### 2) Seminari i të mësuarit të ndërsjelltë në lidhje me eksperiencat e Republikës së Serbisë dhe të Bosnjes dhe Hercegovinës-Republika Srpska. Praktikant e mira do të ndahen në lidhje me veprimtarinë e Komiteteve të Përhershme të Specializuar dhe efektivitetin e tyre në kuadrin e çështjeve të politikës së gjerë.


Afati: fundi i 2018

### 3) Seminari i të mësuarit të ndërsjelltë nga kolegët e KES të IRJ të Maqedonisë te Këshilli Kombëtar i Punës të Republikës së Shqipërisë. Fokusi do të ishte në themelimin e mekanizmeve për monitorimin e rekomandimeve të këshillit kombëtar të punës.

Afati: fundi i 2018.

# ANEKSI

## Rishikimi i Kolegëve i Këshillave Ekonomik dhe Social në Ballkanin Perëndimor



## Matrica Përmbledhëse

SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komisionet e Përhershme Trepalëshe mbështesin punën e Këshillit Kombëtar të Punës (KKP).</li> <li>Përfshirja e KKP në rishikimin e Kodit të Punës.</li> <li>Rezultatet e sesioneve plenare dhe çështjet e diskutuar janë të disponueshme për publikun dhe mediat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mospjesëmarrje ose pjesëmarrje e parregullt e përfaqësuesve të ministrisë në takime.</li> <li>Përfshirje joformale e KKP në debatet Parlamentare dhe në punën e organeve të tjerë kombëtare si Këshilli Ekonomik Kombëtar ose Këshilli i Investimeve të Shqipërisë.</li> <li>Duhet të rishikohet përbërja e KKP dhe palëve të tij konstituive.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Qeveria duhet të marrë pjesë në konsultime me KKP në fazat e hershme</li> <li>Sekretariati i KKP duhet të ndjekë rekomandimet e KKP me Ministrinë përkatëse dhe me qeverinë</li> <li>Qeveria duhet të forcojë kapacitetin teknik dhe human të Sekretariatit dhe të sigurojë më shumë trajnime profesionale për anëtarët e KKP dhe të Sekretariatit</li> <li>Qeveria dhe partnerët socialë duhet të bien dakord për një sërë kriteresh objektive, të lehta për t'u kontrolluar të përcaktuara me ligj (p.sh një ligj i veçantë) dhe duhet të harmonizojë nivelin e përfaqësueshmërisë në KKP për të maksimizuar ndikimet e rezultateve të tij.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Qeveria dhe partnerët socialë duhet të bien dakord për një sërë kriteresh objektive, të lehta për t'u kontrolluar të përcaktuara në një rregullore (p.sh një ligj i veçantë) dhe duhet të harmonizojë nivelin e përfaqësueshmërisë në KKP për të maksimizuar ndikimet e rezultateve të tij.</b></li> <li><b>KKP të miratojë një sistem që bën të mundur vlerësimin e shkallës së realizimit të rekomandimeve në Këshillin e Ministrave.</b></li> </ol>

SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<p><b>BOSNJA DHE HERCEGOVINA</b></p> <p><b>KES i Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• KES takohet rregullisht.</li> <li>• KES rishikon dhe monitoron zbatimin e marrëveshjeve kolektive.</li> <li>• Të gjitha palët janë të përfaqësuara në një nivel të lartë.</li> <li>• Mban takime mbi “çështje tematike”.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• KES ka mandatin që të fokusohet në spektrin e gjerë të çështjeve ekonomike dhe sociale, por në praktikë përjashtohet nga debatet mbi reformat kryesore ekonomike.</li> <li>• E drejta e tyre për diskutime në Komitetet Parlamentare është e kufizuar.</li> <li>• Konsensusi trepalësh rrallë arrihet.</li> <li>• Mungesa e pavarësisë dhe e fondeve të Sekretariatit.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Qeveria dhe partnerët socialë duhet të bien dakord mbi një ligj të veçantë për KES, ku qartësohet roli, formati dhe procesi i konsultimeve të KES dhe autoritetit të tij.</li> <li>2. Qeveria duhet të ketë një detyrim ligjor për Ministrinë që të konsultohen me KES rreth politikave të reja dhe hartimin e ligjeve.</li> <li>3. Qeveria duhet të sigurojë një buxhet të pavarur, të veçantë nga buxheti i Ministrisë së Punës në mënyrë që të fuqizohet autonomia e KES dhe sekretariatit të tij.</li> <li>4. Anëtarët e KES duhet të trajnohen dhe të informohen mbi mënyrën e rritjes së rolit dhe ndikimit të KES.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>KES inicion konsultime trepalëshe dhe bie dakord për hartimin e ligjit mbi KES të FBeH.</b></li> <li>2. <b>KES të realizojë rritjen e ndërgjegjësimit rreth rolit të Qeverisë si promotor, mbështetës dhe rregullues për zbatimin e dialogut social në Ministrinë relevante.</b></li> </ol>



SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<p><b>BOSNJA DHE HERCEGOVINA</b></p> <p><b>KES i Republikës Srpska</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryetari përcaktohet mbi bazat e rotacionit.</li> <li>• KES promovon marrëveshjet kolektive.</li> <li>• Takime të rregullta deri në 2016.</li> <li>• Takimet janë publike me një interes aktiv nga mediat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e besimit ndërmjet palëve të KES.</li> <li>• Pjesëmarrja e Qeverisë dhe Ministrive nuk është e rregullt dhe disa Ministri nuk marrin pjesë ose nuk dorëzojnë hartimin e ligjeve ose politikat e reja të KES për opinione.</li> <li>• Palët e kanë të vështirë të bien dakord për agjendën e përbashkët, ata takohen jo rregullisht dhe ka mungesë të rezultateve të nxitura nga konsensusi.</li> <li>• Debate shumë të polarizuara rreth Ligjit të Punës të miratuar kohët e fundit.</li> <li>• Nuk ka negociata kolektive në sektorin privat dhe problem me njohjen e sindikatave.</li> <li>• Probleme specifike me ndjekjen në nivel Parlamentar të rekomandimeve të KES.</li> </ul> <p>Shënim: Shoqata e Punëdhënësve nuk mori pjesë në procesin e rishikimit të kolegëve</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të gjitha palët duhet të rrisin përfaqësueshmërinë e tyre në KES.</li> <li>2. Qeveria duhet të rrisë burimet teknike dhe njerëzore dhe autonominë buxhetore të KES.</li> <li>3. KES duhet të formojë më shumë komitete të përhershme trepalëshe (aktualisht ka vetëm dy, mbi OSH dhe Punësimin Jo-formal).</li> <li>4. Partnerët socialë duhet të marrin masa për të forcuar marrëveshjet kolektive në section privat.</li> <li>5. Krijimi i besimit ndërmjet palëve dhe rivitalizimi i proceseve të dialogut social.</li> <li>6. Qeveria si e tërë duhet të plotësojë detyrimet e saj konsultative për ligjet, politikat dhe strategjitë kryesore.</li> <li>7. Rishikimi i rregullave dhe procedurave ekzistuese të KES për të arritur një qartësi më madhe dhe një aplikim të përmirësuar.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>KES të rrisë numrin e komiteteve të përhershme trepalëshe.</b></li> <li>2. <b>KES të eliminojë pengesat në procesin e dialogut social.</b></li> </ol>

SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<b>ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• KES luan një rol këshillues për miratimin dhe ratifikimin e Konventave të ILO-s.</li> <li>• Komitetet e përhershme trepalëshe mbështesin punën e KES rreth çështjeve kryesore (p.sh. Marrdhëniet e Punës dhe Punësimi, fiksimit e Pagave Minimale dhe Përgjegjesia sociale e korporatave).</li> <li>• Dy përfaqësues të partnerëve socialë janë pjesë e Sekretariatit të KES.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapaciteti i kufizuar teknik i Sekretariatit dhe Komiteteve të Përhershme.</li> <li>• Prani e vogël e përfaqësuesve të lartë qeveritar.</li> <li>• Konsultime të kufizuara dhe ndikim i vogël mbi reformat ekonomike dhe dialogu social i kufizuar në çështjet e punës.</li> <li>• KES është një institucion shumë i ri që ka nevojë për të formuar reputacionin e tij në shoqëri.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. KES duhet të rrisë bashkëpunimin me insituet kërkimore, akademike dhe organizata të tjera të shoqërisë civile në mënyrë që të arrijë një nivel më të lartë ekspertize.</li> <li>2. Qeveria duhet të miratojë dhe të zbatojë procedura në mënyrë që dokumentet ligjore dhe strategjike të interesit të përgjithshëm ekonomik dhe social të mund të diskutohen vetëm kur shoqërohen nga rekomandimet e KES.</li> <li>3. KES duhet të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin e Qeverisë për nxitur dialogun social me Ministrinë kryesore ekonomike dhe anëtarët e parlamentit.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>KES duhet të rrisë bashkëpunimin me insituet kërkimore, akademike dhe organizata të tjera të shoqërisë civile në mënyrë që të arrijë një nivel më të lartë ekspertize.</b></li> <li>2. <b>KES të iniciojë ndryshime në procedura për të siguruar që hartimi i ligjeve kryesore dhe dokumentëve strategjikë të shoqërohet nga rekomandimet e KES kur i dorëzohen parlamentit.</b></li> </ol>


SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<b>MALI I ZI</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>KES siguron procesin e institucionalizuar të negociatave kolektive.</li> <li>Ekziston një dialogu i mirë dhe besim reciprok ndërmjet partnerëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Madhësia e përfaqësimit të çdo pale duhet të trajtohet për të përmirësuar funksionalitetin e tij.</li> <li>Sekretariati Teknik ka nevojë për rritje të burimeve.</li> <li>Përbërja e përfaqësimit qeveritar duhet të trajtohet sepse ato përfaqësohen vetëm nga një Ministri (e Punës dhe Çështjeve Sociale).</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Qeveria duhet të sigurojë burime më të mëdha teknike për KES.</li> <li>Qeveria dhe partnerët socialë duhet të sigurojnë një qartësi më të madhe mbi fuqitë e KES dhe nivelin e nevojshëm të inputit Ministror.</li> <li>Qeveria dhe partnerët socialë duhet të rishikojnë madhësinë e KES dhe të sigurojnë një kryetar të pavarur.</li> <li>KES duhet të qartësojë rregullat dhe procedurat e votimit.</li> <li>Një mbështetje më e madhe eksperte rreth çështjeve kryesore ekonomike dhe sociale duhet të jetë.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Çdo palë të reduktojë numrin e përfaqësuesve të tij në maksimumi tetë në KES.</b></li> <li><b>KES të përfshijë zyrtarë të lartë nga ministrinë kryesore që mbulojnë zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin sipërmarrës.</b></li> </ol>

SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<b>REPUBLIKA E SERBISË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Strukturat e brendshme mbështetëse të formuara mirë më një “kolegjum” të integruar dhe katër komisione të specializuara të përhershme në KES.</li> <li>Angazhim aktiv i partnerëve socialë në punën e KES.</li> <li>Kryesi me rotacion midis palëve.</li> <li>Monitoron procesin e konsultimit për integrimin dhe pranimin në BE.</li> <li>Organizon takime mujore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Efektiviteti i KES varet nga pjesëmarrja e plotë e anëtarëve të parlamentit dhe Ministrive.</li> <li>Shmangia e KES si pasojë e marrjes së vendimeve politike “emergjente” nënvlerëson autoritetin e këshillit.</li> <li>Roli i partnerëve socialë nuk njihet dhe nuk vlerësohet plotësisht dhe problemet e besimit dalin në pah.</li> <li>Afatet e shkurtër kohorë për debate dhe konsultime.</li> <li>Njohje e kufizuar e rolit të rëndësishëm të KES në proceset e hartimit të ligjeve dhe politikave.</li> <li>Burime të kufizuara për komisionet e përhershme të specializuara dhe Sekretariatit.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ministritë relevante duhet të përfshijnë në faza të hershme partnerët socialë në grupet trepalëshe të punës për hartimin e ligjeve dhe politikave në kuadrin e reformave ekonomike.</li> <li>Qeveria dhe Parlamenti duhet të kërkojë që ligjet të shoqërohen nga rekomandimet e KES kur diskutohen dhe i dorëzohen Parlamentit.</li> <li>Qeveria duhet të sigurojë që opinionet e KES t’i paraqiten edhe Qeverisë dhe Ministrisë Përkatëse dhe në një kohë të shkurtër të merren dhe reagimet në lidhje me këto opinione.</li> <li>KES duhet të miratojë rekomandimet me vendim të shumicës në rastet kur konsensusi nuk arrihet.</li> <li>KES duhet rrisë kuorumin e nevojshëm për takimet e tij.</li> <li>KES duhet të përfshijë edhe opinionet kundërshtuese në rekomandimet e tij.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>KES të iniciojë masat e nevojshme për të siguruar që hartimi i ligjeve dhe dokumentëve strategjikë të shoqërohet nga rekomandimet dhe opinionet e KES kur i paraqiten Parlamentit.</b></li> <li><b>KES të dërgojë rekomandimet e veta qeverisë dhe ministrive përkatëse njëkohësisht dhe të iniciojë ndryshimet procedurale me qeverinë në mënyrë që të marrë reagime nga qeveria në një kohë të shkurtër.</b></li> <li><b>KES dhe partnerët socialë të negociojnë me qeverinë për njohje të plotë të KES si organ këshillimor trepalësh kombëtar dhe për të rritur buxhetin e tij.</b></li> </ol>

SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<b>REPUBLIKA E SERBISË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Strukturat e brendshme mbështetëse të formuara mirë më një “kolegjum” të integruar dhe katër komisione të specializuara të përhershme në KES.</li> <li>Angazhim aktiv i partnerëve socialë në punën e KES.</li> <li>Kryesi me rotacion midis palëve.</li> <li>Monitoron procesin e konsultimit për integrimin dhe pranimin në BE.</li> <li>Organizon takime mujore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Efektiviteti i KES varet nga pjesëmarrja e plotë e anëtarëve të parlamentit dhe Ministrive.</li> <li>Shmangia e KES si pasojë e marrjes së vendimeve politike “emergjente” nënvlerëson autoritetin e këshillit.</li> <li>Roli i partnerëve socialë nuk njihet dhe nuk vlerësohet plotësisht dhe problemet e besimit dalin në pah.</li> <li>Afatet e shkurtër kohorë për debate dhe konsultime.</li> <li>Njohje e kufizuar e rolit të rëndësishëm të KES në proceset e hartimit të ligjeve dhe politikave.</li> <li>Burime të kufizuara për komisionet e përhershme të specializuara dhe Sekretariatit.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>KES duhet të rrisë bashkëpunimin me akademitë, me insitute kërkuese dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që politikat të hartohen në bazë të ekspertizës së tyre teknike.</li> <li>KES duhet të lejojë anëtarët e akademik, ata të insituteve kërkimore dhe të organizatave të shoqërisë civile të marrin pjesë në punën e komisioneve të përhershme të specializuara pa të drejtë vote.</li> <li>Qeveria duhet të njohë plotësisht KES si organ kombëtar këshillues trepalësh.</li> <li>Në mënyrë që të forcohen negociatat kolektive veçanërisht në sektorin privat, KES duhet të organizojë një takim tematik për të diskutuar të paktën një herë në vit gjendjen e negociatave kolektive dhe statusin dhe përforcimin e marrëveshjeve kolektive në nivele të ndryshme.</li> <li>Qeveria duhet të rrisë burimet për të pasqyruar ngarkesën e punës së KES.</li> <li>Qeveria duhet të sigurojë një përfaqësim të përshtatshëm në takimet e KES, duke i dhënë kështu KES më shumë njohje.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>KES të iniciojë masat e nevojshme për të siguruar që hartimi i ligjeve dhe dokumentëve strategjikë të shoqërohet nga rekomandimet dhe opinionet e KES kur i paraqiten Parlamentit.</b></li> <li><b>KES të dërgojë rekomandimet e veta qeverisë dhe ministrive përkatëse njëkohësisht dhe të iniciojë ndryshimet procedurale me qeverinë në mënyrë që të marrë reagime nga qeveria në një kohë të shkurtër.</b></li> <li><b>KES dhe partnerët socialë të negociojnë me qeverinë për njohje të plotë të KES si organ këshillimor trepalësh kombëtar dhe për të rritur buxhetin e tij.</b></li> </ol>

SHTETI	PRAKTIKAT E MIRA	SFIDAT	REKOMANDIMET	REKOMANDIMET E PËRZGJEDHURA PËR ZBATIM TË MËTEJSHËM
<b>KOSOVA (NË PËRPUTHJE ME KUPTIMIN E REZOLUTËS 1244 TË KS TË OKB-SË)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• KES ka prodhuar rekomandime dhe marrëveshje rreth çështjeve kryesore, si p.sh.Pagat Minimale, Strategjia e Punësimit, Marrëveshja Kolektive 2014.</li> <li>• Partnerët Socialë duket se po miratojnë pozicione të përbashkëta për çështjet e rendit të ditës.</li> <li>• Qeveria e përfaqësuar nga pesë Ministra të lartë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nevoja për zyra të përhershme dhe buxhet specifik për veprimtarinë e KES siç përcaktohet nga ligji.</li> <li>• Qeveria duhet të jetë më aktive duke ofruar më shumë të dhëna dhe duke shfaqur iniciativa më të mëdha.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja e vizibilitetit publik në lidhje me rolin dhe sukseset e e KES.</li> <li>2. Strategjia e Komunikimit duhet të hartohet për KES.</li> <li>3. Sigurimi i fondeve shtesë dhe mbështetjes teknike për KES.</li> <li>4. Kërkesa për pjesëmarrje të fokusuar të përfaqësuesve të qeverisë në KES.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Hartimi dhe miratimi i strategjisë së komunikimit të KES për periudhën 2018–2020.</b></li> <li>2. <b>Sigurimi i zyrave të përhershme dhe buxhetit për KES dhe veprimtarinë e tij.</b></li> </ol>





Në kuadër të projektit “Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale” (PePÇS) të financuar nga Bashkimi Europian (BE) , ILO ka projektuar dhe menaxhuar një ushtrim gjithëpërfshirës të rishikimit të kolegëve të strukturës, funksionimit dhe efektivitetit të Këshillave ekzistues Ekonomik dhe Social ( KES ) në Ballkanin Perëndimor.

Rishikimet u kryen nga ekipet e rishikimit të kolegëve të përbërë nga anëtarët e KES që marrin pjesë në projektin e PePÇS me mbështetjen dhe drejtimin e ILO-s.

Ky dokument bazohet në raportet e vendeve që janë hartuar nga ekipet e rishikimit të KES dhe paraqet analizat e gjetjeve dhe rekomandimeve. Për më tepër ky raport përshkruan rregullimet praktike për një proces të rishikimit të kolegëve dhe hapat që duhet të ndërmerren në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të përzgjedhura.